



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

BE QENDRA E KUVENDIT


BE LAJME

shkurt 2019

EUC-numër 42/2019



SESIONI PLENAR I KOMITETIT EVROPIAN TË RAJONEVE



Komiteti Evropian i Rajoneve më 6 dhe 7 shkurt të vitit 2019 mbajti sesionin e 133-të plenar. Në njërin prej debateve si përfaqësues i kryesimit rumun me Këshillin BE mori pjesë Kryeministria Viorika Dançila.

Ulrike Hiler, anëtar i Senatit dhe përfaqësues i Qytetit të Lirë Hanzeatik Bremen, në debat i prezantoi rekomansimet e rajoneve dhe qyteteve për programin Erasmus.

Komiteti Evropian i Rajoneve konsideron se iniciativa e re DiscoverEU, e cila siguron vendkalime rrugore falas për të rinjtë, mund të përforcohet përmes partneritetit publik-privat nga sektori mobilistik.

Në seancën plenare, Komiteti miratoi mendimin për programin Evropa Kreative. Në Mendimin, të miratuar njëzëri në sesionin plenar të Komitetit, parashihet që tekstet e legjislacionit për programin kornizë vijues të Horizont Evropa – BE për hulumtim dhe inovacione – të përfshijnë definicionin preciz të ekosistemeve rajonale dhe qendrave të inovacioneve dhe për përforcim të mëtejshëm të lidhjeve me strategjitë rajonale për specializim të mençur.

Sipas referuesit Birgita Sakreus, anëtar i Këshillit të Qarkut i Dalarna, me rëndësi themelore është ballafaqimi me diparitetet rajonale të cilat rrezikojnë të rriten si pasojë e zvogëlimeve të mundshme të financimit të politikës koheze.

Janë të nevojshme udhëzime etike dhe propozime për përforcimin e së drejtës në nivelin evropian që të sigurohet se transformimet kryesore sociale dhe ekonomike të shkaktuara nga intelgjencia artificiale do të sjellin

Deri tek kualiteti më i mirë i jetës për qytetarët evropianë, thuhet në mendimin e përgatitur nga Jan Trei, kryetar i komunës rurale Viemsi.

Anëtarët e Komitetit Evropian të Rajoneve njëzëri aprovuan mendimin për digjitalizimin e sektorit shëndetësor, gjë e cila do të kontribuojë ndaj Komunikimit në Komisionin Evropian nga prilli 2018 për transformimin digjital të shëndetësisë dhe kujdesin në tregun unik digjital.

Anëtarët e Komitetit Evropian të Rajoneve njëzëri aprovuan mendim për [Programin e 8-të Aksional për Mjedisin Njerëzor \(EAP\)](#).

[RegHub](#) – Pasqyrë e re e rrjetit të qendrave rajonale të Komitetit për implementimin e politikave të BE-së, do të kontribuojë për përmirësimin e mjedisit jetësor nëpërmjet gjetjes së mangësive dhe zgjidhjeve në territorin e BE-së.

Komiteti i Rajoneve miratoi Mendim me të cilin dha mbështetje të plotë për thjeshtëzimin e propozimeve nga Komisioni Evropian në maj të vitit 2018 për përshpejtimin e implementimit të projektit, harmonizimin e procedurës dhe standardet teknike dhe rritjen e interoperabilitetit.

Përmirësimi i implementimit të TEN-T është e një rëndësie të veçantë për kohezionin territorial, ekonomik dhe social i BE-së.

Përmbajtje e lajmeve:

Sesioni plenar i Komitetit Evropian të Rajoneve	1
Në fokusin e Parlamentit Evropian	2-3
Investime për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve	3
Aktivitetet parlamentare lidhur me Çështjet Evropiane	4-6
Konsultime për financimin e infrastrukturës energjetike evropiane	7
Sanksione për Mastercard	7
Subvencione nga Buxheti i BE-së për blegtorinë	8
Transparencë më e madhe e kushteve për punë në BE	8
Udhëzues për komesarët evropianë që do të marrin pjesë në zgjedhjet evropiane	9
Shëndeti i fëmijëve në Bashkimin Evropian	9
Rregulla të reja për qytetarët në BE	10
Interoperabiliteti ndërmjet sistemeve të informacionit të BE-së	10
Rregulla të reja për promovimin e sigurisë së pacientit	11
Kalendari BE / mars 2019	11

<https://cor.europa.eu/en>

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN



www.europarl.europa.eu

Sesioni plenar 11-14 shkurt 2019

Në sesionin plenar të muajit shkurt të PE, eurodeputetët miratuan ndryshime të rregullave për sigurimin e automjeteve me qëllim mbrojtje më të mirë të viktimave në aksidentet rrugore. Qëllimi i propozimit është përmirësimi i Direktivës ekzistuese për sigurimin e automjeteve në pesë fusha. Rregullat e reja kërkojnë nga trupat nacionale për kompensimin t'i mbulojnë shpenzimet që burojnë nga përmirësimi kur siguruesi i automjetit nga pala përgjegjëse është josolvente. Me këtë PE e siguron të drejtën e kompensimit të viktimave për periudhën më së shumti 6 muaj.

Eurodeputetët miratuan rezolutë me të cilën i bëhet apel Komisionit dhe pushteteve nacionale të vendosin një distinkcion të qartë midis kanabisit mjekësor dhe dedikimeve të tjera të kanabisit. Komisioni Evropian dhe vendet-anëtare duhet t'i zgjidhin barrierat rregullatore, financiare dhe kulturore të cilat i rëndojnë hulumtimet shkencore përmes financimit të drejtë të hulumtimeve. Rregullimi i barnave të cilat bazohen në kanabis do të paraqet të ardhura shtesë për pushtetet publike dhe do ta kufizojë tregun jolegal. Nga ana tjetër, me këtë hap do të kufizohet qasja e të miturve në këtë substancë.

Vendet-anëtare të BE-së duhet që më mirë t'i zbatojnë rregullat ekzistuese për mbrojtjen e shtazëve gjatë transportit. Në rezolutën, të miratuar me 411 vota, 43 kundër dhe 110 abstenim, eurodeputetët e ripërsëritën apelin e Parlamentit Evropian të vitit 2012 për zbatimin e fuqishëm dhe të unifikuar të ligjit të BE-së për mbrojtjen e shtazëve gjatë transportit, që për momentin pak po implementohet në disa shtete anëtare. Për zbatimin e rregullave të reja, eurodeputetët propozuan implementimin e teknologjisë moderne (sisteme geolokative) për ndjekjen e vendndodhjes së shtazëve dhe kohëzgjatjen e udhëtimit në kohë reale. Në rezolutë rekomandohet formimi i

Komisionit anketues për mirëqenien e shtazëve të transportuara në BE dhe jashtë saj në fillimin e mandatit të ardhshëm parlamentar.

Parlamenti miratoi rregulla më të thjeshta të përbashkëta për investim në të gjitha rajonet e Unionit dhe iu kundërshtua suspendimit të financimit rajonal të BE-së, varësisht nga qëllimet nacionale ekonomike. Rregullat e reja u miratuan me 460 vota pro, 170 kundër dhe 47 abstenim. Këto rregulla gjithpërfshirëse me të cilat rregullohen shpenzimet rajonale kohezive dhe sociale (2021-2027) janë kyç për investime të vazhdueshme në rajonet e bashkësive, me përkrahje më të madhe të rajoneve më pak të zhvilluara. Parlamenti Evropian është i gatshëm për fillimin e negociatave me ministrat e BE-së.

Avancimi i mekanizmit për mbrojtje civile të BE-së, deri më tani i testuar në vitet 2017 dhe 2018 në përballjen me zjarret, furtunat dhe përmbytjet e mori mbështetjen e Parlamentit Evropian.

Qëllimi i legjislativës së re, jozurtarisht të akorduar me Këshillin në dhjetor, është që t'u ndihmohet shteteve-anëtare të reagojnë shpejt dhe në mënyrë më efikas ndaj katastrofave natyrore dhe të shkaktuara nga faktorë të tjerë, përmes ndarjes më efikase të mjeteve për mbrojtje civile. Ligji krijon rezervë resursesh (RescEU), siç janë avionë për shuarjen e zjarreve në pyje, pompa me kapacitet të lartë, spitale terreni dhe ekupe mjekësore për raste urgjente, për përdorimin në të gjitha llojet e rasteve emergjente. RescEU do të ndihmojë kur resurset të shpërndara nga ana e vendeve-anëtare nuk janë të mjaftueshme t'u përgjigjen katastrofave të caktuara, me vendim të Komisionit Evropian.

Parlamenti Evropian dha dritë jeshile për marrëveshjet për tregti të lirë dhe investime midis BE-së dhe Singaporit. Me marrëveshjen për tregti të lirë do të evitohen praktikisht të gjitha tarifatat midis dy palëve në afat prej pesë vjetësh. Marrëveshja përfshin përforsimin e të drejtave të punëtorëve dhe mbrojtjen e ambientit jetësor, element shumë i rëndësishëm për Parlamentin.

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

Me marrëveshjen për mbrojtjen e investimeve rregullohet zgjidhja e kontesteve gjyqësore midis investitorëve dhe shtetit, ndërsa Marrëveshja për partneritet dhe bashkëpunim e zgjeron bashkëpunimin jashtë fushës së tregtisë. Hyrja në fuqi e këtyre dy marrëveshjeve do të pasojë pas ratifikimit nga vendet anëtare të BE-së.

Eurodeputetët miratuan rregulla të reja për rregullimin e shërbimeve për konvertimin e valutës euro në pagesat jashtëkufitare. Bankat duhet në mënyrë të barabartë të paguajnë për shërbimin si në pagesat jashtëkufirit, ashtu edhe në pagesat e brendshme. Shpenzimet për konvertimin e valutave duhet të jenë transparente. Konsumatorët do të njoftohen në rrugë elektronike (mesazh tekstual, e-mail ose përmes aplikacionit bankar mobil apo veb të pagesit) për shpenzimet e aplikueshme për konvertimin e valutës. Këto shërbime për informim duhet t'u ofrohen pa pagesë. Bankat do të duhet t'i publikojnë shpenzimet e vlerësuara për konvertimin e valutës në rast të tranferteve të parave para se të bëhet pagesa.

Me qëllim mbrojtjen e sektorëve strategjikë, PE dha pëlqim për vendosjen e mjetit për pasqyrimin e investimeve të huaja direkt (IHD) në bazë të sigurisë në nivel të BE-së. Dispozitat e reja e forcuan meksnizmin për bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave midis vendeve anëtare të BE-së, të cilat mund të japin komente për IHD të cilat janë të orientuara drejt vendeve të tjera anëtare. Komisioni Evropian mund të kërkojë informacione dhe të japë mendim drejtuar vendit ku planifikohet investimi, por vendimi definitiv i mbetet vendit të tanguar.

Struktura dhe burimet e investimeve IHD në BE ka ndryshuar në mënyrë drastike në 20 vitet e kaluara. Investimet nga Kina janë rritur për gjashtë herë, ndërsa nga Rusia më shumë se dyfish.

Parlamenti Evropian theksoi nevojën për formimin e shpejtë të Shtëpia e popujve e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese të vendit. Eurodeputetët i ftuan autoritetet e B dhe H të vazhdojnë me reformat kushtetuese, politike dhe zgjedhore me qëllim avancimin e procesit të integritetit në BE.



www.europarl.europa.eu

INVESTIME PËR PËRMIRËSIMIN E KUALITETIT TË JETËS SË QYTETARËVE

Komisioni Evropian më 15 shkurt të këtij viti publikoi investim prej 116,1 milionë euro për projektet më të reja të integruara të financuara përmes LIFE – [Program për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike](#). Programi do japë mbështetje për 12 projekte të mëdha ekologjike dhe klimatike në dhjetë vende anëtare të BE-së: Austri, Bullgari, Çeki, Estoni, Finlandë, Greqi, Hungari, Itali, Portugali dhe Slloveni. Projektet e integruara e përmirësojnë kualitetin e jetës të qytetarëve dhe japin ndihmë në harmonizimin e legjislacionit me legjislacionin e BE-së në pesë fusha: natyrë, ujë, kualitetin e ajrit, uljen e emisioneve të gazrave serrë dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike. Projektet e integruara LIFE janë implementuar në vitin 2014 me qëllim të ndihmojnë vendet anëtare në

harmonizimin me legjislacionin kyç për mjedisin jetësor, natyrën dhe klimën. Në vijim janë rreth 1100 projekte. Për buxhetin vijues afatgjatë të BE-së 2021-2027, Komisioni propozon rritje të financimit për 60% përmes Programit LIFE.

12 projektet e zgjedhura janë me buxhet prej 215,5 milionë euro, përfshirë 116,1 milionë euro me bashkëfinancim nga BE. Vendet anëtare mund të përdorin edhe burime të tjera të financimit, përfshirë edhe fondet bujqësore, rajonale dhe strukturore, Horizont 2020, si dhe fondet nacionale dhe investimet në sektorin privat. Në këtë mënyrë arrijmë të mobilizimi i 3,2 miliardë euro plotësuese. Programi LIFE ekziston që nga viti 1992 dhe deri më tani bashkëfinancon më shumë se 4600 projekte nëpër BE dhe shtete të treta.



<http://europa.eu>

AKTIVITETET PARLAMENTARE LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



www.sobranie.mk



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Talat Xhaferi dhe delegacioni i përbërë nga kryetarja dhe anëtarët e Grupit parlamentar për bashkëpunimin e Kuvendit me Parlamentin e Republikës së Sllovenisë, Frosina Tashevskaja Remenski, Nada Cipusheva dhe Shpresa Hadri, vizitën e tyre dyditëshe zyrtare në Republikën e Sllovenisë e filluan këtë takim me nikoqirin, Kryetarin e Kuvendit të Sllovenisë, Dejan Zhdan më 11 shkurt të vitit 2019. Gjatë kohës së vizitës zyrtare Kryetari Xhaferi realizoi takime të ndara me Presidentin e Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor, Kryeministrin e Republikës së Sllovenisë, Marjan Sharec dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Sllovenisë, Mirko Cerar. Në takimet z. Xhaferi i informoi për aktivitetet aktuale në Kuvend dhe shprehu falënderim për mbështetjen e Republikës së Sllovenisë në përpjekjet për integrimin e vendit tonë në NATO dhe BE. Gjatë takimeve, Kryetari Xhaferi përkujtoi se Republika e Maqedonisë së Veriut me përkushtim i plotëson reformat e domosdoshme në fushat prioritare të ingranuara në Planin 3-6-9 dhe Planin 18. Në takimet bashkëbiseduesit u pajtuan se është e nevojshme të intensifikohet bashkëpunimi midis dy shtetesh, sidomos në fushën e ekonomisë, që kontribuon për Evropë më të sigurt. Me rastin e ratifikimit të Protokollit për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë Veriore në NATO, Kryetari Xhaferi kishte fjalë rasti para deputetëve në Kuvendin e Republikës së Sllovenisë. Në ekspozitën e tij theksoi rolin e të dy parlamenteve të cilat në dekadat e kaluara vendosën marrëdhënie bilaterale intensive dhe efikase.

Në kuadër të vizitës në Slloveni, Delegacioni i udhëhequr nga Kryetari i Kuvendit, më 12 shkurt të vitit 2019 realizoi takim me Komisionin për Çështje të Bashkimit Evropian, Komisionit të Mbrojtjes dhe Grupin për miqësi në Kuvendin e Republikës së Sllovenisë. Në takim Kryetari Xhaferi i kushtoi vëmendje të posaçme rëndësisë dhe komplektitetin e procesit të bisedimeve, me ç'rast nënvizoi se këtu do të jetë e nevojshme përvoja dhe njohuritë e Republikës së Sllovenisë. Në fund të takimit, u theksua rëndësia për përforsimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit në nivelin e parlamenteve në fushat që janë në interes të përbashkët. Në këtë drejtim, përfaqësuesit e Grupeve për bashkëpunim ndërmjet dy shteteve theksuan se do të ndërmarrin iniciativë për zhvillimin e komunikimit nëpërmjet të cilit mund të realizohen aktivitete të përbashkëta në fushën e ekonomisë, kulturës dhe mjedisit jetësor.



Kryetari i Kuvendit, Tala Xhaferi më 5 shkurt 2019 realizoi takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Iniciativës së Evropës Qendrore (IEQ), senatorin italian Roberto Antonjone. Në takim bashkëbiseduesit shkëmbyen më shumë informacione dhe mendime rreth bashkëpunimit të mëparshëm dhe aktual të vendit tonë në kuadër të IEQ. Kryetari Xhaferi, theksoi se roli i bashkëpunimit parlamentar në kuadër të IEQ-së është me rëndësi të madhe dhe theksoi se delegacioni parlamentar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në mënyrë aktive do të vazhdojë në punën e dimensionit parlamentar të IEQ edhe në periudhën e ardhshme. Me këtë hapen shumë mundësi për komunikim direkt dhe indirekt dhe bashkëpunim midis shtetesh në të gjitha fushat.



Takimi me Roberto Antonjone realizoi edhe Delegacioni i Kuvendit në Dimensionin Parlamentar të Iniciativës së Evropës Qendrore (DP IEQ). Në takim morën pjesë shefi i Delegacionit, Fadil Zendeli dhe anëtarët Elizabeta Kançevska-Milevska dhe Mirsada Emini-Asani. Në takim senatori Antonjone e përshëndeti nënshkrimin e protokolleve aderuese të NATO-s, moment i rëndësishëm për stabilitetin e rajonit dhe shprehu gatishmëri për mbështetje të plotë të procesit nga ana e IEQ-së.

AKTIVITETET PARLAMENTARE LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Me rastin e Ratifikimit të Protokollit të Paktit Veriatlantik për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, Kryetari Talat Xhaferi kishte fjalim të tij para deputetëve të Republikës së Shqipërisë më 14 shkurt, dhe Republikës së Bullgarisë më 20 shkurt 2019. Në fjalimin e Kryetarit z. Xhaferi foli për miratimin e fundit të ndryshimeve kushtetuese me të cilat në bazë të Marrëveshjes së Prespës, të nënshkruar nga qeveritë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Greqisë u tejkalua një kontekst i gjatë pothuajse tri dekada rreth emrit kushtetues të shtetit tonë. Kryetari Xhaferi shprehu shpresën se këtë vit Republika e Maqedonisë së Veriut do të marrë datën për fillimin e bisedimeve me Bashkimin Evropian.



Kryetari Xhaferi më 5 shkurt 2019 realizoi takim me zëvendësin e Kryetarit të Qeverisë të Republikës së Kroacisë dhe ministër i Mbrojtjes, z. Damir Këršticeviq, i cili qëndron në vizitë dyditëshe zyrtare në Republikën e Maqedonisë. Në takim ishte i pranishëm edhe deputeti Pavle Bogoevski si anëtar i Komisionit për mbrojtje dhe siguri. Ministri Këršticeviq shprehu mbështetje të fuqishme për Republikën e Maqedonisë së Veriut në procesin e integritit në Bashkimin Evropian dhe theksoi se gjatë kohës kryesimit të Kroacisë me BE-në në vitin 2020, fokusi do të vendoset në hapësirën e Evropës Juglindore.

Më 4 shkurt 2019 Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i përgjithshëm z-nj. Cvetanka Ivanova realizuan takim me ambasadorin e ShBA-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Xhes Bejli, në të cilin ishte e pranishme edhe drejtoresha e zyrës së USAID për Maqedoni, Greçen Birkël,

Në takim u diskutua për bashkëpunimin të deritanishëm midis Kuvendit dhe Organizatës amerikane për zhvillim ndërkombëtar (USAID) përmes projekteve të realizuara nga Instituti Nacional Demokratik, të cilët e mbështesin punën e Kuvendit. Kryetari Xhaferi shprehu kënaqësinë dhe falënderimin për bashkëpunimin dhe mbështetjen e deritashme dhe theksoi se Kuvendi është i hapur për bashkëpunim të mëtejshëm me partnerët tanë strategjikë. Duke e ndarë qëndrimin e njëjtë të Kryetarit Xhaferi, Ivanova dhe bashkëbiseduesit u pajtuan që ka rezultate nga bashkëpunimi i deritanishëm dhe konkluduan që ekziston interes reciprok, dëshirë dhe hapësirë që ky bashkëpunim të vazhdojë të avancohet edhe në të ardhmen.



Delegacioni i Kuvendit në përbërje: Agim Shaqiri, zëvendëskryetar dhe Hari Lokvenec, anëtar i Komisionit për çështje ekonomike, më 21 shkurt 2019 morën pjesë në takimin kushtuar efikasitetit energjetik në organizatën e Bashkësisë energjetike dhe Forumin parlamentar për Evropën Juglindore për efikasitetin energjetik dhe klimë, në organizim të shoqatës gjermane për bashkëpunim, që u mbajt në Bruksel, Mbretërinë e Belgjikës. Fjalim mbajti edhe deputeti Lokvenec, me ç'rast theksoi se në periudhën e kaluar është vërejtur përparim nga ana e palëve në bashkësinë energjetike në arritjen e synimeve të vendosura për pjesëmarrje të burimeve të rigjenerueshme në prodhimin e përgjithshëm të energjisë. "Si vende nënshkruese të Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike, jemi të obliguar t'i kushtojmë më shumë vëmendje të përdorimit të burimeve të rigjenerueshme dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor", theksoi Lokvenec.



AKTIVITETET PARLAMENTARE LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



www.sobranie.mk

Kryetari i Kuvendit z. Talat Xhaferi më 26 shkurt u takua me znj. Natali Loazo, ministre e Çështjeve Evropiane pranë Ministrisë për Evropë dhe për Punë të Jashtme të Republikës së Francës. Pjesë e Delegacionit ishin edhe z-nja Marta de Sidrak, kryetare e Grupit Francë - Ballkani Perëndimor në Senat dhe z. Bertran Sor, deputet në Asamblesë Nacionale, kryetar i Grupit për Miqësi Francë - Maqedonia e Veriut. Në takim ishte i pranishëm edhe deputeti Pançe Ivanov, kryetar i Grupit për Bashkëpunim në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut me Parlamentin e Republikës Franceze. Kryetari Xhaferi shprehu kënaqësi që marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy vendeve i karakterizon dialog stabil dhe i hapur, falënderoi edhe për mbështetjen që Franca e jep për procesin e eurointegritimeve tona dhe theksoi se duke e pasur parasysh rolin ndikues të Francës edhe në NATO edhe në BE. Ministria Loazo, në emër të Francës drejtoi urime për arritjen e Marrëveshjes së Prespës, duke e theksuar me këtë rast rolin e rëndësishëm të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut në procesin e përfundimit të kontestit me Greqinë. Ajo theksoi se Franca do të jetë me ne në rrugën tonë kah Bashkimi Evropian deri në arritjen e suksesit ndërsa mbështetje në emër të Senatit dhe në emër të Asamblesë Nacionale shprehën edhe senatorja de Sidrak dhe deputeti Sor.

Komisioni për Çështje Evropiane mbajti takim pune me ministren e Çështjeve Evropiane në Ministrinë për Evropë dhe për Punë të Jashtme të Republikës së Francës, Natali Loazo. Kryetari i Komisionit Artan Grubi iu falënderua për mbështetjen e deritashme franceze në proceset eurointegruese të vendit. Me rastin e qëndrimeve të ndryshme midis opozitës dhe pozitës, Grubi theksoi se “të gjithë ne thithim ajrin e njëjtë, na ngroh dielli i njëjtë, kemi bindje të ndryshme, por qëllimi është i përbashkët, Maqedonia evropiane”. Grubi theksoi se për ne është me interes të posaçëm të kemi mbështetjen e Francës duke e pasur parasysh vendin e saj dhe ndikimin në strukturat euro-atlantike. Ministria Loaza e përsëriti perspektivën evropiane të rajonit dhe në këtë kontekst edhe të Maqedonisë së Veriut, por duke sugjeruar se nevojitet përmbushja e të gjitha kriterëve në kapitujt. Ajo e vërtetoi mbështetjen franceze për proceset tona eurointegruese, me ç'rast theksoi se duhet të merret parasysh edhe mundësia që BE-ja të reformohet në aspekt të funksionimit të tij, para zgjerimit të ardhshëm me vende anëtare të reja.



Me ftesë të AP m të NATO-s, në takimet e përbashkëta të Komitetit të AP të NATO-s me Këshillin Veri-atlantik (NAC), të cilat u mbajtën prej 18 deri më 20 shkurt 2019 në Bruksel, morën pjesë deputetët Ilija Dimovski, shef i delegacionit të Kuvendit në AP të NATO-s dhe Vesel Memedi, nënkryetar i Kuvendit dhe anëtar i delegacionit. Mysafir special në sesion ishte Nensi Pelosi, spoker i Kongresit të ShBA-ve, e cila që në fillim e përshëndeti delegacionin tonë dhe i shprehu urimet për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, ku theksoi se Marrëveshja e Prespës është arritje e madhe për vlerat demokratike botërore.

Shefi i delegacionit, Ilija Dimovski, në fjalimin e tij para të pranishmëve, falënderoi për urimet e sinqerta dhe theksoi se nënshkrimi i Marrëveshjes aderuese për anëtarësim të vendit tonë në NATO paraqet finalizim të integritetit tonë euro-atlantik. Tha që shteti ynë ndërmorri vendime të dhimbshme dhe të vështira të cilat meritojnë respekt nga të gjithë anëtarët e NATO-s, ku theksoi se shteti ynë është ajo e cila bëri më së shumti për zgjidhjen përfundimtare të këtij konteksti tredekadësh.

Nënkryetari Memedi në pyetjen shtruar Mogerinit e theksoi nevojën e bashkëpunimit më të fuqishëm midis NATO-s dhe BE-së, veçanërisht ndaj shteteve më të vogla, të cilat presin mbështetje më të madhe në konsolidimin e tyre drejt këtyre dy organizatave të mëdha ndërkombëtare.



KONSULTIME PËR FINANCIMIN E INFRASTRUKTURËS ENERGJETIKE EVROPIANE

Banka Investuese Evropiane si një nga financuesit më të mëdhenj në infrastrukturën energjetike globale, filloi konsultime publike për mbështetjen këshilldhënëse dhe financuese në këtë sektor, për përf forcimin e ndikimit të kreditimit të ardhshëm energjetik.

Në kuadër të tre muajve të ardhshëm, BIE bashkë me palët e interesuara, aksionarët, shoqatat industriale, shoqërinë civile dhe sektorin privat, do të bashkohen me qëllim që të zhvillojnë politikë të re për kreditimin që do t'i përkrah politikën energjetike dhe qëllimet klimatike të BE-së deri në vitin 2030.

Dialogu me palët e prekura do të reflektohet mbi përkrahjen e mëparshme të BIE për investime në energjetikë dhe do t'i shqyrojë trendet kyçe dhe sfidat investuese me të cilat përballlet ky sektor.

Konsultimet do të përfshijnë analiza se si me investimet e ardhshme të mbështetura nga BIE mund të zvogëlohet shpenzimi i energjisë elektrike nëpërmjet efikasitetit

energjetik, mbështetje më të mirë të burimeve të regjenerueshme energjetike, përmirësimit të mbështetjes financiare dhe konsultante për inovacionet energjetike dhe sigurinë e infrastrukturës me rëndësi thelbësore për transicionin energjetik.

Diskutimi dhe të përfshijë edhe mendime specifike për mbështetjen e investimeve në energjetikë në vendet në zhvillim dhe ekonomitë në zhvillim jashtë Evropës.

Politika e re do t'i zëvendësojë kriteret për kreditë energjetike të BIE, të aprovuara para gjashtë vjetësh, në kontekst të synimeve Evropa 2020, të cilat siguruan përkrahje të fuqishme për financimin e energjisë së pastër, përfshirë edhe energjinë e rigjenerueshme, efikasitetin energjetik dhe rrjetet e ndërlidhura elektrike. Banka Investuese Evropiane është një nga huadhënësit më të mëdhenj botëror në fushën e energjetikës.

Në pesë vitet e fundit, BIE siguroi më shumë se 49 miliardë euro për investime në energjetikë në Evropë.

www.eib.org



SANKSIONE PËR MASTERKARD

Komisioni Evropian e dënoi Mastercard me 570,5 milionë euro për shkak të kufizimit të mundësisë të sigurojnë kushte më të mira për tregtarët, taksa më të volitshme gjatë pagesave dhe zbatimin e rregullatave të cilat shkaktuan rritje artificiale të shpenzimeve për pagesë me kartelë krediti në dëm të konsumatorëve dhe tregtarëve të BE-së. Mastercard është skema e dytë kartelash për nga madhësia në rajonin ekonomik evropian për dhënie të kartelave dhe transaksione me vlerë. Sipas skemës së Mastercard, bankat ofrojnë shërbime lidhur me kartelat pagesore nën grupin e përbashkët, Mastercard dhe Maestro. Në prill të vitit 2013, Komisioni hapi hetim formal antimonopol kundër Mastercard për të vlerësuar nëse këto rregulla për “përfitime tejkufitare” kanë qenë në kundërshtim me rregullat antimonopol në BE. Në korrik të vitit 2015, Komisioni dha Deklaratë me kundërshtime.

Hetimi i Komisionit Evropian konstatoi se për shkak të dispozitave të Mastercard,

shitësit paguanin shërbime më shtrenjta bankare sesa që do t'i kishi paguar nëse lirisht do të mund të zgjidhnin shërbime më të lira bankare në mbarë Evropën. Si rezultat i kësaj, Komisioni vendosi të shqiptojë dënim me para ndaj Mastercard.

Komisioni konkludoi që rregullat e Mastercard deri më 9 dhjetor 2015 e kanë shkelur nenin 101 të Marrëveshjes së funksionimit të BE-së, e cila ndalon kontrata midis kompanish apo vendime të shoqatave të kompanive që e parandalojnë dhe kufizojnë konkurrencën në kuadër të Tregut unik të Bashkimit Evropian.

Komisioni Evropian krijoi vegël me të cilën subjektet më lehtë mund të informojnë për ekzistimin e sjelljes antimonopole. [Vegla](#) mbron anonimitetin e informatorëve përmes sistemi special të shifruar për mesazhe me komunikim dydrejtësh.

<http://europa.eu>



SUBVENCIONE PËR BLEGTORINË NGA BUXHETI I BE-së



Sipas një raporti të ri të Greenpeace, nga 12 shkurti 2019, subvencionet e BE për mbështetjen e bujqësisë dhe ndihmën e sektorit blegtoral arrijnë në 28.5 deri 32.6 miliardë euro. Ose do të thotë mes 18% dhe 20% të Buxhetit të BE-së.

"Këto fonde duhet të mbështesin mbarështimin e kafshëve dhe fermerët në rritjen e kafshëve nëpërmjet metodave të përgjegjshme mjedisore dhe për të inkurajuar ushqim të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, kryesisht bimë", thuhet në raport.

Blegtoria ndikon në rritjen e emetimeve të gazrave serrë më shumë se kultivimi i perimeve dhe frutave. Megjithatë, fermerët shpesh bëjnë zgjedhje në biznesin e tyre bazuar në nxitjet e tregut dhe të qeverisë. Për të reduktuar prodhimin e mishit nevojitet konsum më i ulët i mishit.


Sipas një sondazhi të kryer në 2014, vlerësohet se nëse qytetarët e BE konsumojnë 50% më pak mish, prodhime

qumështi dhe vezë, ato do të reduktojnë emetimet e gazrave serrë nga bujqësia me 25-40%. Në të njëjtin vit, Paneli Ndërqeveritar i Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, raporti tregoi se ka potencial shumë më të madh për të reduktuar emetimet e gazrave serrë në sektorin e bujqësisë nëpërmjet ndryshimeve në konsum sesa në përmirësimet teknologjike.

Nga pikëpamja shëndetësore, BE-ja duhet të reduktojë konsumin e mishit të kuq dhe të konsumojë dy herë më shumë fruta dhe perime të jetë e mundur për të ulur ngrohjen globale dhe njëkohësisht për të udhëhequr një mënyrë jetese të shëndetshme. Raporti vlerësoi se në 2017, rreth 71% e tokës së punueshme të Evropës u përdorën për të prodhuar ushqim të kafshëve për sektorin e bagëtive, të cilat Greenpeace vuri në dukje si "përdorim joefikas i burimeve natyrore".

<https://euobserver.com>

TRANSPARENÇË MË E MADHE E KUSHTEVE PËR PUNË NË BE



Presidenca rumune e Këshillit të BE-së dhe Parlamenti European arritën një marrëveshje paraprake mbi udhëzimet që duhet të ofrojë kushte më transparente dhe të parashikueshme të punës në BE, marrëveshja do t'i dorëzohet përfaqësuesve të shteteve anëtare në Këshillin e BE-së për miratim.

Qëllimi i legjislacionit të ri është t'i përgjigjet sfidave të tregut të punës, të shkaktuara nga ndryshimet demografike, digjitalizimi dhe format e reja të punësimit. Pas miratimit të legjislacionit të ri, Direktiva e vitit 1991 do të hiqet.

Me direktivat e reja, punëdhënësit do të duhet të informojnë punëtorët për aspektet e rëndësishme të punësimit, si:

- identitetin e palëve në marrëdhëniet e punës, vendin dhe natyrën e punës;
- shumën themelore fillestare të shpërblimit dhe shumën e pushimit të paguar;
- Kohëzgjatja e ditës standarde të

punës ose javës kur orari i punës mund të parashikohet.

Kur skema e punës është pak a shumë e pa parashikueshme, punëdhënësit gjithashtu duhet të informojnë punëtorët për orët dhe ditët që mund të kërkojnë për të punuar një periudhë minimale prej njoftimit paraprak të punëtorëve para fillimit të punës dhe shuma e orëve të garantuara të paguara.

Marrëveshja paraprake përfshin një numër të të drejtave minimale për punëtorët:

- Mundësia e punës paralele me një punëdhënësit tjetër;

- kufizimin e punës testuese në një maksimum prej 6 muajsh, me periudha më të gjata të lejuara vetëm kur është në interes të punonjësit ose justifikuar nga natyra e punës; dhe

Marrja e trajnimit falas kur një trajnim i tillë kërkohej sipas legjislacionit evropian ose kombëtar.

www.consilium.europa.eu

UDHËZUES PËR KOMESARËT EVROPIANE QË DO TË MARRIN PJESË NË ZGJEDHJET EVROPIANE

Komisioni Evropian ka botuar udhëzime praktike për standardet etike për anëtarët e Komisionit Evropian të cilët do të marrin pjesë në zgjedhjet evropiane për Parlamentin Evropian në maj të këtij viti. Udhëzimet janë të dizajnuara për të garantuar zbatimin e harmonizuar të Kodit të Sjelljes së rishikuar që i lejon Komisionerët të marrin pjesë aktive në zgjedhjet parlamentare Evropiane dhe në të njëjtën kohë të kryejnë detyrat e tyre të punës.

Në fund të vitit 2016, Presidenti i Komisionit Evropian Jean-Claude Juncker ka propozuar një kod të ri të sjelljes që mundëson pjesëmarrjen aktive të Komisionerëve në PE garën zgjedhore, ndër të tjera, si kandidatë të çojë (vrapues) për postin e kryetarit të Parlamentit Evropian. Kodi i Sjelljes i ndryshuar hyri në fuqi në janar 2018.

Sipas Kodit të Sjelljes, komisionerët do të keni për të shmangur situatat e konfliktit të interesave, si dhe situatat kur për shembull ish-komisionerët ndërmend për

të punuar në fushat e lidhura me departamentet e tyre të mëparshme, të cilat së pari do të duhet të konsultohet Komiteti për etikë të pavarur. Vendimet e Komisionit dhe opinionet e Komitetit lidhur me këto vendime shpallen publikisht.

Udhëzimet e KE-së deklarojnë se komisionerët që marrin pjesë në një fushatë zgjedhore duhet ta informojnë Kryetarin e Komisionit.

Komisionerët nuk do të jenë në gjendje të përdorin faqen e internetit të Komisionit Evropian për qëllimet e fushatës. Udhëzimet tregojnë qartë se mbështetja e përgjithshme financiare ose materiale për fushatat dhe pjesëmarrësit duhet të synojë vetëm për të organizuar fushatën.

Nëse ndodh një situatë që mund të paraqitet konflikti i interesit, komisioneri që merr pjesë në fushatë duhet të informojë presidentin e KE-së, i cili do të marrë masat e nevojshme.



SHENDETI I FËMIJËVE NË BASHKIMIN EVROPIAN

Në Bashkimin Evropian, më shumë se 95% e fëmijëve kanë shëndet të përgjithshëm të mirë ose shumë të mirë. Kjo përqindje sipas grupmoshës është:

- Te fëmijët nën moshën 5 vjeç është 96.5%
- Te fëmijët e moshës 5 deri në 9 vjeç është 95.9%, dhe
- Te fëmijët e moshës 10-15 vjeç, kjo është 95.2%.

Përqindja e fëmijëve të shëndetit të përgjithshëm të cilëve konsiderohet të jetë i keq ose shumë i keq është nën 1% për të gjitha grupmoshat e fëmijëve. Më pak se 5% e fëmijëve në BE konsiderohen se kanë kufizime në aktivitete për shkak të problemeve shëndetësore:


- Kufizime mesatare - 3.7%, dhe
- Kufizime serioze - 1.2%

Në pothuajse të gjitha shtetet anëtare, më pak se 1% e fëmijëve nën pesë vjeç kanë kufizime serioze në aktivitetet për shkak të problemeve shëndetësore.

Këto të dhëna për shëndetin e fëmijëve në BE publikohen nga Eurostat (Zyra Statistikore e BE-së). Të dhënat janë marrë nga moduli ad hoc për kujdesin shëndetësor dhe shëndetin e fëmijëve në 2017 të BE-së - Statistikat mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës

(EU-SILC). Hulumtimi mbi BE-SILC është një burim reference e statistikave krahasuese BE-së për shpërndarjen e të ardhurave, varfërisë dhe kushteve të jetesës. Sondazhi përfshiu Shtetet e mëposhtme anëtare të BE-së: Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Danimarka, Gjermania, Estonia, Irlanda, Greqia, Spanja, Franca, Kroacia, Italia, Qipro, Letoninë, Lituaninë, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Sllovakia, Finlanda, Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar.

<https://ec.europa.eu/>



RREGULLA TË REJA PËR QYTETARËT NË BE



Qytetarët e BE-së që jetojnë ose udhëtojnë në një vend tjetër të BE-së duhet të marrin një vulë për të vërtetuar vërtetësinë e dokumenteve publike. Çështja përballlet me rreth 17 milionë qytetarë të BE-së që jetojnë në një vend tjetër dhe rreth dy milionë njerëz që punojnë ose studiojnë në një dhe të jetojnë në një vend tjetër të BE-së. Sipas rregullave të reja të Komisionit Evropian, shtyp dhe burokracisë që lidhen me të nuk do të jetë i nevojshëm në paraqitjen e dokumenteve publike të lëshuara në një vend të BE-së me autoritetet e një vendi tjetër të BE-së. Qytetarët nuk do të jenë më të detyruar të japin një përkthim zyrtar të dokumentit të tyre publik.


Komisioneri Evropian për Drejtësi, konsumatorët dhe Barazi Gjinore, Vera Zhurova theksoi se rregullat e reja të kenë një ndikim të rëndësishëm në jetën e përditshme të qytetarëve të cilët jetojnë ose duan të jetojnë në një vend tjetër të BE-së.

Rregullat e reja i japin fund shumë procedurave burokratike:

- dokumente publike të lëshuara në një shtet anëtar të BE-së duhet të pranohet si autentik nga autoritetet në një shtet tjetër anëtar, pa nevojën për një vulë të origjinalitetit;
- detyrimi i qytetarëve për të siguruar kopjen e vërtetuar dhe përkthimin e vërtetuar të dokumenteve të tyre publike;
- Rregullorja përcakton masa mbrojtëse kundër mashtrimit: kur autoriteti mund të arsyeshme dyshim vërtetësinë e dokumentit publik, ju mund të kontrolloni vërtetësinë e autoritetit përkatës që ka lëshuar dokumentin në vendet e tjera të BE-së me platformë të veçantë IT.

Këto rregulla janë propozuar nga Komisioni Evropian në prill të vitit 2013, pas informacionit të shumta nga qytetarët, të cilët ballafaqohen me procedura të gjata dhe të komplikuar. Rregullat u miratuan në qershor 2016, dhe Shtetet Anëtare të BE kishin një afat dyvjeçar për t'u përshtatur me thjeshtësitë e reja.

INTEROPERABILITETI NDËRMJET SISTEMEVE TË INFORMACIONIT TË BE-së



Bashkimi Evropian paraqet rregulla të reja për ndërveprim midis sistemeve informative të BE-së në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Presidenca rumune e Këshillit të BE-së dhe përfaqësuesve të Parlamentit Evropian kanë arritur një marrëveshje paraprake për dy rregulloret e propozuara duke krijuar një kornizë për ndërveprimin ndërmjet sistemeve informative të BE-së në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme.

Sistemi për interoperabilitet lejon qasje të shpejtë të autoriteteve të gjitha informatat relevante në dispozicion në bazat e të dhënave ekzistuese për të verifikuar të dhënat biometrike në zbulimin e rasteve të identiteteve të dyfishta ose të shumëfishta.

Ministri i Brendshëm i Rumanisë Carmen Daniela Dani theksoi se

ndërveprimi në mes të sistemeve të informacionit do të mundësojë sistemet të plotësojnë njëri-tjetrin, të ndihmojnë në lehtësimin dhe identifikimin e saktë të personave dhe të kontribuojë në luftën kundër mashtrimit.

Sistemet e përfshira me dy rregullativat do të ofrojnë mbështetje për autoritetet kombëtare në fushën e sigurisë, menaxhimit të kufijve dhe migracionit, vizave dhe përpunimin e azilit. Këto përfshijnë input sistemi / output (EES), Sistemin Informativ vizave (VIS), autorizimin e Sistemit Evropian Informativ të pasagjerëve (ETIAS), Eurodac, Sistemi Informativ Shengen (SIS) dhe sistemin e informacionit për të dhënat penale evropiane për shtetasit e vendeve të treta (ECRIS-TCN), si dhe bazat e të dhënave të tjera relevante të dokumenteve të udhëtimit.

www.consilium.europa.eu/

RREGULLAT E REJA PËR PROMOVIMIN E SIGURISË SË PACIENTIT

Që nga 09 shkurti 2019, janë aplikuar rregulla të reja për tiparet e sigurisë për barnat e shitura dhe lëshuara në BE. Nga tani e tutje, kompanitë farmaceutike në prodhimin e barnave me recetë duhet të vendosin në paketimin e barit një barcode 2-D dhe një lloj pajisje kundër falsifikimit të paketimit.

Farmacitë (duke përfshirë farmacitë në internet) dhe spitalet duhet të kontrollojnë vërtetësinë e barnave para se të lëshojnë ilaçin e pacientit. Ky është hapi i fundit në zbatimin e Direktivës së Barnave të Falsifikuara, të miratuar në vitin 2011, për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ilaçeve të shitura në BE. Pothuajse 7 vjet pas miratimit dhe zbatimit të Direktivës së Barnave të Falsifikuara, do të jetë e plotë falë futjes së verifikimit dhe sigurimit që nga fillimi i prodhimit të ilaçit deri te përdorimi i saj nga pacienti.

Komisioneri Evropian për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore, Vutenis Andriukatis vuri në dukje se çdo farmaci apo spital duhet të ketë një sistem për zbulimin më efikas të ilaçeve të falsifikuara. Komisioneri dërgoi një mesazh

inkurajues për ministrat e shteteve anëtare të BE-së, për të monitoruar zbatimin e sistemit të ri dhe për të ndihmuar të gjithë palët e interesuara në rregullat e reja që do të parandalojnë përfundimin e ilaçeve të falsifikuara në duart e pacientëve.

Në periudhën e ardhshme, sistemi i ri do të monitorohet për të përcaktuar nëse funksionon siç duhet.

Barnat që janë prodhuar para 9 shkurtit 2019, pa karakteristika të sigurisë, do të mbetet në treg deri në datën e skadimit. Sistemi i ri i verifikimit do të kërkojë farmacistët dhe spitalet si persona të autorizuar për të kontrolluar vërtetësinë e produkteve në të gjithë zinxhirin e furnizimit.



<http://europa.eu>



KALENDARI / Mars 2019

1. Sesionet parlamentare të Parlamentit Evropian: 11-14 / 03/2019 dhe 25-28 / 03/2019, Strasburg;
2. Dita Evropiane e Konsumatorëve, 27/03/2019, Bruksel, Belgjikë;
3. Evropa juaj - Zëri yt! 2019 (YEYS 2019), 20-23 / 03/2019, Bruksel, Belgjikë.
4. Takimi i Këshillit Evropian, 21-22.03.2019, Bruksel.

European Union
 Newsroom

[EUROPA](#) > [Newsroom](#) > [Calendar](#)

[Home](#) | [Highlights](#) | [Press releases](#) | **[Calendar](#)** | [Audiovisual](#) | [Press contacts](#) | [Press facilities](#) | [Subscription services](#) | [About the EU](#)

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS
 By topic

By organiser

By type

BY MONTH
 March

Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat	Sun
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

Vjegëza të dobishme për publikimet elektronike të BE-së

<https://publications.europa.eu/en/home>

https://europa.eu/european-union/documents-publications/libraries-archives_en

<http://www.europarl.europa.eu/visiting/en/brussels/parlamentarium>



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokali 414 dhe 289

Faksi: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Projekti IPA Asistencë Teknike për Parlamentin" u implementua në Kuvend në periudhën Janar 2011 - Qershor 2012, qëllimi i të cilit ishte forcimi i kapaciteteve institucionale të Parlamentit dhe në këtë mënyrë përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve.

Në kuadrin e projektit IPA, ndihma financiare dhe eksperte u sigurua për krijimin e një qendre të BE-së në Kuvend.

Qëllimi i krijimit të Qendrës së BE-së është që të sigurojë deputetët në Kuvend dhe në Asamblenë Parlamentare me qasje më të mirë në informata lidhur me çështjet e BE-së.

Qendra e BE-së është e organizuar në kuadër të Sektorit për Mbështetjen e Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian.

Qendra e BE-së ka një bibliotekë të librave dhe botimeve nga fusha të ndryshme të politikave

